



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 01.02.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-3917/12 për zyrtarin e lartë z.Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dhënë dorëheqje nga funksioni si Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike "IBER LEPENCI".**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqitën rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.**

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-3917/12, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, ka qenë duke ushtruar edhe funksionin e Kryesuesit të Bordit në Ndërmarrjen Publike "IBER LEPENCI", që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 09.11.2012, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave zyrtari i lartë z.Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, është drejtuar me një shkresë dhe na ka njoftuar se e ka marrë shkresën njoftuese dhe se mendon se angazhimi i tij në këto dy funksione nuk paraqet konflikt të mundshëm të interesit, duke pasur parasysh disa prova dhe interpretimin e ligjit që ai e ka bërë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.12.2012 i ka dërguar shkresën e dytë njoftuese për konstatim të konfliktit të interesit dhe e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Zenelaj, se brenda afatit të paraparë, të marre të gjitha hapat për ta shmangur gjendjen e mundshme të Konfliktit të Interesit, përndryshe Agjencia është e obliguar të veproj sipas nenit 18.8 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë z. Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, me datën 11.01.2013 ka sjellë në Agjencinë kundër Korrupsionit, deklaratën, që ka paraqitur dorëheqjen nga postin i kryesuesit të Bordit në Ndërmarrjen Publike "NH- IBER LEPENCI-Sh.A" para organeve kompetente.

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve dhe në bazë të gjendjes së krijuar në këtë proces konstatojmë se :

Zyrtari i lartë z.Nazmi Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, dhe nuk gjendet me në situatën e përshkruar si Konflikt të mundshëm të Interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik pasi që ka ofruar dorëheqjen nga pozita e Kryesuesit të bordit në Ndërmarrjen Publike "NH- IBER LEPENCI".

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, dhe funksionit si kryesues i bordit në ndërmarrjen publike "NH- IBER LEPENCI".

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqitën rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Pretëni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

